

PAULIN STERKAJ



Datëlindja: 05.07.1961

Vendlindja: Koplík

Email: Paulin.Sterkaj@parlament.al

Jetëshkrimi:

Ka përfunduar studimet universitare në Institutin e Fiskulturës “Vojo Kushi” në Tiranë.

Ai ka disa eksperiencë në punë si Oficer i Ministrisë së Punëve të Brendshme, komandant i Forcave Speciale të Policisë së Rendit i Repartit “brisku”, Shef i Komisarariatit të Policisë në Lezhë, më pas në Dibër. Ai ka qenë i angazhuar në veprimtari private si sipërmarrës në fushën e hidrokarbureve, të restoranteve dhe të ndërtimit.

Ka disa kualifikime në fushën e sigurimit të personaliteteve të larta në luftën kundër terrorizmit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (1996), specializim policor në Kajro në Egjipt (1996), ka marrë pjesë në një seminar parlamentar në Garmisch, Gjermani (2006).

Z. Sterkaj është “Mjeshtër i Merituar” i sportit, ka marrë medaljen “Shqiponja e Artë” në vitin 1996. Është dekoruar nga Presidenti i Republikës në vitin 2017.

Prej katër legjislaturash ai është anëtar i Komisionit Parlamentar të Ekonomisë dhe Financave dhe i Komisionit të Sigurisë Kombëtare. Gjithashtu, ai është anëtar i Asamblesë Kombëtare të Partisë Socialiste.